



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI
NDËRMJET
BANKËS QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURENCËS

Me qëllim të bashkëpunimit dypalësh në përmbushjen e funksioneve të tyre sipas legjislacionit në fuqi, Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës më 2 shtator 2011, lidhin këtë:

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

Neni 1

PARIME TË PËRGJITHSHME

- (a) Kjo marrëveshje synon lehtësimin e bashkëpunimit reciprok përmes shkëmbimit të informacionit relevant ndërmjet dy institucioneve: Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (në vijim BQK) dhe Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (në vijim AKK), në përmbushjen e funksioneve të tyre sipas legjislacionit në fuqi.
- (b) Përmes kësaj marrëveshje, institucionet nënshkruese zotohen të shkëmbejnë informacion relevant për përmbushjen e funksioneve të tyre ligjore.
- (c) Kjo marrëveshje nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore për ndonjërin nga institucionet nënshkruese. Kjo marrëveshje nuk ndikon në ndonjë ligj ose akt nënligjor në fuqi. Gjithashtu nuk ndikon në ndonjë marrëveshje tjetër që BQK ose AKK kanë me institucione tjera. Përcaktimet e kësaj marrëveshjeje, nuk mund të cenojnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej institucioneve nënshkruese, që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, në bazë të të cilit institucionet janë themeluar dhe funksionojnë.

Neni 2

INSTITUCIONET NËNSHKRUESE

- (a) Sipas Ligjit nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, AKK është institucion përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës së lirë, efektive në treg, është organ publik i pavarur në kryerjen e detyrave të veta dhe përveç tjerash:
 - (i) Kontrollon rregullat konkurruese të ndërmarrjeve në treg,
 - (ii) Nxjerr akte detyruese për zbatimin e tyre,
 - (iii) Bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore për sigurimin e rregullave të vendosura për konkurrencën.
- (b) Sipas Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, BQK është institucion i pavarur me kompetenca të plota si person juridik, dhe si objektiv kryesor ka nxitjen dhe mbajtjen e sistemit financiar stabil duke përfshirë një sistem të sigurt, të

qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Kompetencat e Bankës Qendrore mes tjerash përfshijnë:

- (i) Përgjegjësinë ekskluzive për licencimin, mbikëqyrjen, regjistrimin dhe rregullimin e institucioneve financiare në Kosovë,
- (ii) Autorizimin për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatim të dispozitave të këtij ligji dhe shqiptimin e masave administrative.

Neni 3

QËLLIMI I MARRËVESHJES

Qëllimi i kësaj marrëveshje është lehtësimi i bashkëpunimit reciprok përmes shkëmbimit të informacionit relevant ndërmjet institucioneve nënshkruese.

Kjo marrëveshje përcakton procedurat dhe rregullat e bashkëpunimit dypalësh, si në vijim.

Neni 4

KËRKESAT PËR INFORMACION

- (a) Kërkesat për informacion bëhen me shkrim në njërën nga gjuhët zyrtare.
- (b) Kërkesa për informacion duhet të jetë e plotë, e qartë dhe përmbajtësore. Ajo duhet t'i drejtohet personit kontaktues të institucionit të caktuar në shtojcën 1 të kësaj marrëveshjeje.
- (c) Kërkesat për informacion duhet të sigurojnë:
 - (i) një përshkrim të përgjithshëm lidhur me subjektin për të cilin kërkohet informacion,
 - (ii) qëllimin për të cilin kërkohet informacion,
 - (iii) kohën e preferuar për marrjen e përgjigjes.

Neni 5

EKZEKUTIMI I KËRKESËS PËR INFORMACION

Institucioni, pranuesi i kërkesës, pasi analizon atë, i siguron institucionit kërkues informacionin që ai zotëron, duke u bazuar në ligjet në fuqi. Në rast se kërkesa nuk mund të plotësohet, institucioni marrës i kërkesës duhet t'i ofrojë përgjigje me shkrim institucionit që kërkon informacionin, në lidhje me shkaqet që e pengojnë dhënien e informacionit.

Neni 6

PERDORIMI I INFORMACIONIT DHE KONFIDENCIALITETI

- (a) Çdo informacion i siguruar sipas kësaj marrëveshjeje nuk duhet të përdoret nga asnjë palë e tretë, pa pëlqimin paraprak të institucionit që e ka siguruar këtë informacion.
- (b) Institucioni kërkues do të përdorë informacionin e siguruar vetëm:
- (i) për qëllimet e përcaktuara në kërkesë ose
 - (ii) për qëllime qartësisht ligjore.

Neni 7

RISHIKIMI I MARRËVESHJES DHE NDËRPRERJA E MARRËVESHJES

- (a) Institucionet nënshkruese, kurdoherë që e vlerësojnë të nevojshme, mund ta rishikojnë këtë marrëveshje për plotësime eventuale, të diktuar nga ndryshimet ligjore aplikative, ose kërkesat tjera të të dy institucioneve.
- (b) Ndryshimi i kësaj marrëveshjeje, mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të dyja palëve.
- (c) Kjo marrëveshje mund të ndërpritet në mënyrë të njëanshme nëse njëra palë e njofton me shkrim palën tjetër së paku 30 ditë përpara, ose në pajtim mes palëve.

Neni 8

HYRJA NË FUQI

Kjo marrëveshje lidhet për periudhë kohore të pakufizuar dhe hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës.

Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje dhe secila nga palët mban një kopje në original.

**Autoriteti Kosovar
i Konkurrencës**



Osman EJUPI
Kryetar

**Banka Qendrore e
Republikës së Kosovës**



Gani GËRGURI
Guvernator

Shtojcë 1 – Personat kontaktues

Personi i kontaktit për AKK:

Osman Ejupi, Kryetar i AKK
Adresa: Rr. "Nena Tereza", p.n. Prishtinë
Ndërtesa e Kuvendit
E-mail: osman.ejupi@ks-gov.net
Tel: +377 44 494 834

Personi i kontaktit për BQK:

Nexhat Kryeziu, Zëvendësgubernator për Mbikëqyrjen e Institucioneve Financiare
Adresa: Rruga "Garibaldi" 33, Prishtinë
E-mail: nexhatkryeziu@bqk-kos.org
Tel: + 381 38 226 822